

VENDIM
Nr. 393, datë 20.6.2012

**PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 285, DATË 4.5.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË
KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE DHE TË TATIMIT
MBI TË ARDHURAT PERSONALE, SIPAS NOMENKLATURËS SË VEPRIMTARISË
EKONOMIKE, PËR TË PUNËSUARIT NË SEKTORIN JOPUBLIK, QË KRYEJNË PUNË TË
PAKUALIFIKUARA E TË KUALIFIKUARA, SI DHE PËR PERSONELIN DREJTUES E
TEKNIKO-EKONOMIK TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 124 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999
“Kodi i Procedurave Administrative”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Revokimin e vendimit nr. 285, datë 4.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës referuese mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të tatimit mbi të ardhurat personale, sipas nomenklaturës së veprimtarisë ekonomike, për të punësuarit në sektorin jopublik, që kryejnë punë të pakualifikuara e të kualifikuara, si dhe për personelin drejtues e tekniko-ekonomik të tyre”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha